

VENDIM
Nr. 226, datë 6.9.2022

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“COSMOGRAL” SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 10, pikat 1 dhe 3, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.9.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1510 prot., datë 2.9.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Cosmogral’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Cosmogral” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1498 prot., datë 25.8.2022, ka paraqitur aplikimin për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike në zbatim të aneksit A të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- Në zbatim të përcaktimeve të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; dokumentacionin financiar dhe fiskal dhe dokumentacionin teknik për aktivitetin tregtimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin në zbatim të nenit 9, pika 1, gjerat “a” dhe “b”, nenit 9, pika 2, gjerat “a”, “b” dhe “e”, nenit 9, pika 3, gjerat “b”, “c” dhe “d” si dhe nenit 9, pika 4.8, gjerat “a”, “b” dhe “c”.

- Mungesa e dokumentacionit ka të bëjë me:

nenin 9, pika 1, germa “c”: Shoqëria duhet të saktësojë deklaratën e saj në lidhje me ushtrimin e aktiviteteve të tjera.

nenin 9, pika 2, germa “c”: Shoqërisë duhet të shtojë në objektin e veprimtarisë së saj në QKB edhe veprimtarinë për të cilën kërkon të licencohet.

nenin 9, pika 2, germa “d”: Shoqëria duhet të përcjellë në ERE vërtetimet përkatëse të gjykatës dhe prokurorisë, për administratorin dhe vetë shoqërinë.

nenin 9, pika 3, germa “a”: Shoqëria duhet të përcjellë në ERE vërtetimin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore me detyrimin e shlyer.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Cosmogral” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti